




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr. 272/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi– Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Matrix IM” sh.p.k & X shpk, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Eor Group” sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje për zë” me nr. prokurimit: 623-19-1778-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- KK Rahovec, më datën 26.07.2019, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, pjesërisht si bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Matrix IM” sh.p.k & X shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje për zë” me nr. prokurimit: 623-19-1778-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- KK Rahovec.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Furnizim me pajisje për zë” me nr. prokurimit: 623-19-1778-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- KK Rahovec, dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Matrix IM” sh.p.k & X shpk, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 05.04.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 10.04.2019.

Operatori ekonomik ankues "Matrix IM" sh.p.k & X shpk, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 03.06.2019, me nr. 272/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje për zë" me nr. prokurimit: 623-19-1778-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- KK Rahovec, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 13, 59, 60 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 17.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe Ekspert të jashtëm Teknik për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues dhe eksperti i jashtëm teknike në raportin e dt: 25.06.2019, sqaron përgjigjet për pretendimin 1, 2, 3, 4: " 1. Deklarata nën betim - mungon hederi dhe foteri si ne dosjen e tenderit pra nuk është numri i prokurimit dhe emri i projektit. 2. Te pozita, Shpresa Veliu ekziston si menaxhere ndërsa në dokumente te biznesit është si drejtoresh, kurse Adresa dallon nga dokumentet e biznesit. 3. Deklarata për specifikat teknike : Mungon numri i prokurimit dhe autoriteti kontraktues se kujt ju ka drejtuar 4. Deklarata për liferimin e pajisjeve nuk është konform kërkesë së AK-së sepse Mungon numri i prokurimit dhe emri i autoriteti kontraktues, prandaj nuk është e vlefshme."

Përgjigje: Ky fakt nuk qëndron, pasi e gjithë përmbajtja e Deklaratave është e njëjte me deklarata si ne FDT andaj si Pretendim është i paqëndrueshëm



Përgjigje për pretendimin 5: “Vërtetimi i gjykatës themelore Prishtinë, nuk është ofruar siç është kërkuar, kopje e noterizuar, por është ofruar vetëm kopje”

Përgjigje: Sqarim ne baze te dosjes te tenderit përkatësisht vërtetimet te gjykatës i cili ndodhe pjesë e këtij dokumentacionit nga skanimi shihet çarte se është skanuar dokumenti origjinal dhe si pretendim i tille nuk qendrore, ne rast te ndonjë dyshimi AK gëzon te drejtën te kërkoj Originalin ose kopjen e noterizuar për verifikim.

Përgjigje për pretendimin 6: “Pozicini 1, në paramasë është kërkuar vetëm 1 model nga AK, ndërsa OE i shpallur fitues i ka ofruar disa modele si p.sh janë ofruar 12 modele ku një pjesë e këtyre nuk i plotëson specikat teknike të parapara në paramasë. Pra OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me variante, ndërsa variantet me dosje të tenderit nuk kanë qenë të autorizuar. Katalogu\_tasker ”

Përgjigje, Ky fakt nuk qëndron, për faktin se ne katalog ka pajisje te cilat i plotësojnë kriteret, dhe si e tille nuk e ndan katalogun vetëm për një produkt, mirëpo për te gjitha produktet e ofertuar.

Përgjigje për pretendimin 7: “OE fitues nuk ka specifikuar cilat konektor, po ashtu ka ofruar disa seri të konvektorëve prej faqes 27 deri ne 37, pra plotë IO faqe me konektor të ndryshëm. Pra OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me variante, ndërsa variantet me dosje të tenderit nuk kanë qenë të autorizuar. faqe 37 katalogu. NP3X-BAG-max. 0 7 mm.-SP55max. 0 5 mm.SP81max. 5 mm.-SP80max. 5 mm.SPF3XLRMmax. 0 7 mm.-SPM3XLRMmax. 7 mm.-SPS6.3max. 6,5 mm.”

Përgjigje, Ky fakt nuk qëndron, për faktin se ne katalog ka pajisje te cilat i plotësojnë kriteret, dhe si e tille nuk e ndan katalogun vetëm për një produkt, mirëpo për te gjitha produktet e ofertuar.

Përgjigje për pretendimin 8: “Mungojnë në tërësi specifikat teknike të PC-laptopit të kërkuar dhe OE fitues nuk ka kod për tregtimin e PC në veprimtaritë e biznesit.”

Përgjigje, Ky fakt qëndron, kjo për faktin se sipas kërkesës kërkohet qe te gjitha produktet te kenë Katalog/broshure mirëpo OE nuk ka ofruar një dokument te tille.

Përgjigje për pretendimin 9: “Mungon në tërësi specifikimi teknik i projektorit, nuk është fare në katalog, ndërsa në FTD kërkohet broshura.”

Përgjigje, Ky fakt qëndron, kjo për faktin se sipas kërkesës kërkohet që të gjitha produktet të kenë Katalog/broshurë mirëpo OE nuk ka ofruar një dokument të tillë.

Përgjigje për pretendimin 10: “Mungon në tërësi specifikimi teknik i projektorit, nuk është fare në katalog në FTD kërkohet broshurë.”

Përgjigje, Ky fakt qëndron, kjo për faktin se sipas kërkesës kërkohet që të gjitha produktet të kenë Katalog/broshurë mirëpo OE nuk ka ofruar një dokument të tillë.

Përgjigje për pretendimin 11: “AK ka kërkuar vetëm 1 mikset me 16 kanale, ndërsa OE fitues ka ofruar 2 modele 8 kanalesh dhe 16 kanalesh, ndërsa nuk i përkrah 740-786 MHz dhe frekueca në 150m katalogu i miksetes 3/16MPM SERIES MANUAL\_v1.1, pra ka ofruar mikset me të vogël se që ka kërkuar AK-ja. Mikseta nuk përkrah vifi mikrofoni shih katalogun -PM\_SERIES\_MANUAL\_v1.1

1. Pozicioni i 2 Fumizim me 2 wireless hand mic -Pajisja e ofruar përkrah vetëm 1 dhe gjuha e përshkrimit teknik është bullgare.

Komplet katalogu është ofruar në gjuhën bullgare i cili fakt është në kundërshtim me nenin 13 paragrafi 4 i LPP-së, prandaj OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

AK-ja ka kërkuar 40 hz deri 18000 hz, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar 50Hz - 15,000Hz, Pra nuk janë përmbushur specifikimet teknike nga OE i rekomanduar për kontratë.”

Përgjigje, Ky fakt qëndron, kjo për faktin se sipas kërkesës së AK-së, OE ka ofruar një Katalog/broshurë në gjuhën Bullgare dhe i njëjti sipas këtyre dokumenteve nuk plotëson kriteret minimale teknike.

Andaj në bazë të gjitha shkresave për këtë lëndë konstatoj se OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e parapara sipas njoftimit për Kontratë dhe rekomandoj që ky Aktivitet të kthehet në Rivlerësim.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Operatori ekonomik “Matrix IM” sh.p.k & X shpk, përmes parashtresës me shkrim të datës: 25.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues KK Rahovec, përmes parashtresës me shkrim të datës: 25.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.07.2019, ku kanë qenë prezent kryetari i paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues mungon, eksperti teknik u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Mullabazi deklaroj: Provat që i dorëzoj përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues i dha në shqimë dhe shqyrtim ekspertit teknik i cili do të jepe një sqarim shtesë lidhur me ekspertizën.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues Teknik z. Hisenaj deklaroj: Në lidhje me lenden 272/19, pasi pranova dokumentet shtesë të cilët nuk ishin pjesë e dosjes së këtij AP (prokurimit) dhe të njëjtat i pranova vetëm në seancë do t'i shqyrtoj në kohën optimale dhe do t'i dërgoj plotësimin e raportit tek institucionet Autoriteti Kontraktues dhe OSHP.

Paneli shqyrtues sqaron se eksperti i jashtëm teknik gjatë seancës kryesore të dt: 26.07.2019, pranon nga përfaqësuesi i autoriteti kontraktues KK Rahovec, dokumentet shtesë të cilët nuk ishin pjesë e dosjes së këtij aktiviteti të prokurimit. Eksperti i jashtëm teknik me anë të shkresës të datës: 26.07.2019, plotëson raportin e ekspertizës si në vijim:

Ashtu siç edhe u diskutua në seancë po e plotësoj raportin e ekspertizës, kjo për faktin se në këtë seancë kam pranuar dokumentet të reja të cilat nuk ishin të ngarkuara në e-prokurimin, dhe gjatë përpilimit të ekspertizës të njëjtat nuk kanë mund të merren për bazë.

Pretendimi numër 8, duke u bazuar në shkresë të paraqitura gjatë seancës rezulton se AK ka kërkuar sqarime shtesë për këtë pikë, çka OE ka sjell katalogun për llap top dhe sipas këtij dokumenti rezulton se i njëjti plotëson të gjitha Kërkesat Teknike.



Pretendimi numër 9, duke u bazuar ne shkresa te paraqitura gjatë seancës rezulton se AK ka kërkuar sqarime shtesë për këtë pike, me çka OE ka sjell katalogun për projektor dhe sipas këtij dokumenti rezulton se i njëjti plotëson te gjitha Kërkesat Teknike.

Pretendimi numër 10, duke u bazuar ne shkresa te paraqitura gjatë seancës rezulton se AK ka kërkuar sqarime shtesë për këtë pike, me çka OE ka sjell katalogun për projektor me te gjitha specifikat dhe sipas këtij dokumenti rezulton se i njëjti plotëson te gjitha Kërkesat Teknike.

Përgjigje për pretendimin 11. Edhe pas plotësimit te dokumentacionit sipas dokumentit te paraqitur në seancë nuk rezulton te jene te qarta se ky produkt përkrah apo jo këto pjese, andaj prape konsideroj se kjo lëndë duhet te kthehet ne Rivlerësim dhe AK duhet u bazuar ne nenin 72 të LPP-së, te sqarojë me dokumentet shtesë për te njëjtin produkt se a plotëson këto kërkesa teknike apo jo.

“AK ka kërkuar vetëm 1 mikset me 16 kanale , ndërsa OE fitues ika ofruar 2 modele 8 kanalesh dhe 16 kanalesh, ndërsa nuk i përkrah 740-786 MHZ dhe frekuencat ne 150m katalogu i miksetes 3/16 MPM SERIES MANUAL\_v1.1, pra ka ofruar mikset me të vogël se çka ka kërkuar AK-ja.

Mikseta nuk përkrah vifi mikrofoni shih katalogun-PM\_ SERIES MANUAL\_v1.1.

1. Pozicioni i 2 Furnizim me 2 wireles hand mic-Pajisja e ofruar përkrah vetëm 1 dhe gjuha e përshkrimit teknik është bullgare.

Komplet katalogu është ofruar ne gjuhe bullgare i cili fakt është ne kundërshtim me nenin 13 paragrafi 4 i LPP-së, prandaj OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm .

AK –ja, ka kërkuar 40 hz deri 18000hz , ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar 50Hz-15,000Hz, pra nuk janë përmbushur specifikimet teknike nga OE i rekomanduar për kontratë.

Përgjigje, ky fakt qëndron , kjo për faktin se sipas kërkesës se AK-së, OE ka ofruar një Katalog / broshurë ne gjuhen bullgare dhe i njëjti sipas këtyre dokumenteve nuk plotëson kriteret minimale teknike.

Konkludim :

Pas analizimit të te dhënave te paraqitura ne seance kam pasqyruar ndryshimet për pretendimet 8, 9, 10, ndërsa për pretendimet 11, edhe pas konsultimeve te dokumenteve te paraqitura ne këtë seancë mbetem prapa ne te njëjtit qëndrim, me çka konsideroj se lënda duhet te kthehet ne rivlerësim dhe te sqarohet produkti i ofruar për këtë pozicion.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit të jashtëm teknik, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, dhe plotësimit të raportit shtesë të eksperti të jashtëm teknik sqaron se sa i përket pretendimeve të OE ankues "Matrix IM" sh.p.k & X shpk, se OE i rekomanduar për kontratë "Eor Group" sh.p.k, nuk i ka plotësuar këto kërkesa ashtu siç janë kërkuar në FDT, kërkesa si në vijim: 1. Deklarata nën betim - mungon hederi dhe foteri si në dosjen e tenderit pra nuk është numri i prokurimit dhe emri i projektit.

2. Te pozita, znj. Shpresa Velu ekziston si menaxhere ndërsa në dokumente të biznesit është si drejtoresh, kurse Adresa dallon nga dokumentet e biznesit.

3. Deklarata për specifikat teknike : Mungon numri i prokurimit dhe autoriteti kontraktues se kujt ju ka drejtuar.

4. Deklarata për liferimin e pajisjeve nuk është konform kërkesë së AK-së sepse Mungon numri i prokurimit dhe emri i autoriteti kontraktues, prandaj nuk është e vlefshme."

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertës shqyrtues, konstaton se janë të paqëndrueshëm pretendimet e lartpërmendura për faktin se e gjithë përmbajtja e Deklaratave është e njëjtte me deklarata si në FDT.

Sa i përket pretendimit nr. 5 të OE ankues "Matrix IM" sh.p.k & X shpk, se OE i rekomanduar për kontratë "Eor Group" sh.p.k, nuk e ka plotësuar këtë kërkesë ashtu siç është kërkuar në FDT, "Vërtetimi i gjykatës themelore Prishtinë, nuk është ofruar siç është kërkuar, kopje e noterizuar, por është ofruar vetëm kopje"

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertës shqyrtues, sqaron se në bazë të dosjes të tenderit përkatësisht vërtetimet të gjykatës i cili ndodhe pjesë e këtij dokumentacionit nga skanimi shihet çarte se është skanuar dokumenti origjinal dhe si pretendim i tillë nuk qëndron, në rast të ndonjë dyshimi autoriteti kontraktues gëzon të drejtën të kërkojë Origjinalin ose kopjen e noterizuar për verifikim.

Sa i përket pretendimit nr. 6 të OE ankues "Matrix IM" sh.p.k & X shpk, se OE i rekomanduar për kontratë "Eor Group" sh.p.k, nuk e ka plotësuar këtë kërkesë ashtu siç është kërkuar në FDT

"Pozicini 1, në paramasë është kërkuar vetëm 1 model nga AK, ndërsa OE i shpallur fitues i ka ofruar disa modele si p.sh janë ofruar 12 modele ku një pjesë e këtyre nuk i plotëson specifikat teknike të parapara në paramasë. Pra OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me variante, ndërsa variantet me dosje të tenderit nuk kanë qenë të autorizuar. Katalogu\_tasker "

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertës shqyrtues, konstaton se pretendimi i



lartpërmendur nuk qëndron, për faktin se në katalog ka pajisje të cilat i plotësojnë kriteret, dhe si e tillë nuk e ndan katalogun vetëm për një produkt, mirëpo për të gjitha produktet e ofertuar.

Sa i përket pretendimit nr. 7 të OE ankues "Matrix IM" sh.p.k & X shpk, se OE i rekomanduar për kontratë "Eor Group" sh.p.k, nuk ka specifikuar cilat konektor, po ashtu ka ofruar disa seri të konvektorëve prej faqes 27 deri në 37, pra plotë 10 faqe me konektor të ndryshëm. Pra ka ofertuar me variante, ndërsa variantet me dosje të tenderit nuk kanë qenë të autorizuar. faqe 37 katalogu. NP3X-BAG-max. 0 7 mm.-SP55max. 0 5 mm.SP81max. 5 mm.-SP80max. 5 mm.SPF3XLRMmax. 0 7 mm.-SPM3XLRMmax. 7 mm.-SPS6.3max. 6,5 mm."

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertës shqyrtues, konstaton se pretendimi i lartpërmendur nuk qëndron, për faktin se në katalog ka pajisje të cilat i plotësojnë kriteret, dhe si e tillë nuk e ndan katalogun vetëm për një produkt, mirëpo për të gjitha produktet e ofertuar.

Sa i përket pretendimit nr. 8 të OE ankues "Matrix IM" sh.p.k & X shpk, se OE i rekomanduar për kontratë "Eor Group" sh.p.k, tek pozicioni 1 6 "Mungojnë në tërësi specifikat teknike të PC-laptopit të kërkuar dhe OE fitues nuk ka kod për tregtimin e PC në veprimtaritë e biznesit." Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertës shqyrtues, sqaron se autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë për këtë pike, ku OE i rekomanduar për kontratë ka sjell katalogun për llap top dhe sipas këtij dokumenti rezulton se i njëjti plotëson të gjitha Kërkesat Teknike.

Sa i përket pretendimit nr. 9 të OE ankues "Matrix IM" sh.p.k & X shpk, se OE i rekomanduar për kontratë "Eor Group" sh.p.k, tek pozicioni 1 7 –projektor – Mungon në tërësi specifikimi teknik i projektorit, nuk është fare në katalog, ndërsa në FTD kërkohet broshura."

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertës shqyrtues, sqaron se autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë për këtë pike, ku OE i rekomanduar për kontratë ka sjell katalogun për projektor dhe sipas këtij dokumenti rezulton se i njëjti plotëson të gjitha Kërkesat Teknike.

Sa i përket pretendimit nr. 10 të OE ankues "Matrix IM" sh.p.k & X shpk, se OE i rekomanduar për kontratë "Eor Group" sh.p.k, tek pozicioni 1 8 –"Mungon në tërësi specifikimi teknik i projektorit, nuk është fare në katalog në FTD kërkohet broshura."

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertës shqyrtues, sqaron se autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë për këtë pike, ku OE i rekomanduar për kontratë ka sjell katalogun



për projektor me të gjitha specifikat dhe sipas këtij dokumenti rezulton se i njëjti plotëson të gjitha Kërkesat Teknike.

Sa i përket pretendimit nr. 11 të OE ankues "Matrix IM" sh.p.k & X shpk, se OE i rekomanduar për kontratë "Eor Group" sh.p.k, tek pozicioni 1 10 - "AK ka kërkuar vetëm 1 mikset me 16 kanale, ndërsa OE fitues ka ofruar 2 modele 8 kanalesh dhe 16 kanalesh, ndërsa nuk i përkrah 740-786 MHZ dhe frekueca në 150m katalogu i miksetes 3/16MPM SERIES MANUAL\_v1.1, pra ka ofruar mikset me të vogël se që ka kërkuar AK-ja.

Mikseta nuk përkrah vifë mikrofoni shih katalogun -PM\_SERIES\_MANUAL\_v1.1

1. Pozicioni i 2 Fumizim me 2 wireles hand mic -Pajisja e ofruar përkrah vetëm 1 dhe gjuha e përshkrimit teknik është bullgare.

OE ankues pretendon se komplet katalogu është ofruar në gjuhën bullgare i cili fakt është në kundërshtim me nenin 13 paragrafi 4 i LPP-së, prandaj OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, dhe AK-ja ka kërkuar 40 hz deri 18000 hz, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar 50Hz - 15,000Hz, Pra nuk janë përmbushur specifikimet teknike nga OE i rekomanduar për kontratë."

Paneli shqyrtues konform ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertës shqyrtues, konstaton se është i bazuar pretendimi i lartpërmendur i OE ankues për faktin se sipas kërkesës së AK-së, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një Katalog/broshurë në gjuhën Bullgare dhe i njëjti sipas këtyre dokumenteve nuk plotëson kriteret minimale teknike.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës si dhe në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit si dhe sqarimet e ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertit shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht obligon autoritetin kontraktues Komuna e Rahovecit, që gjatë rivlerësimit konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ti verifikojë dhe të kërkojë sqarime shtesë për të gjitha dëshmitë-dokumentet dhe referencat (e OE-së, të rekomanduar për kontratë), të cilat i konteston operatori ekonomik ankues, ashtu siç u cek më lartë, më saktësisht të vërtetojë se OE i rekomanduar për kontratë për produktin e ofruar për pozicionin nr. 1-10, a ka ofertuar në bazë të kërkesës të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu paneli shqyrtues në bazë të shkresave të lëndës të cilat i ka pas në dispozicion si dhe në bazë të ekspertit të jashtëm teknik dhe ekspertit shqyrtues konstaton se AK KK Rahovec, ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 13 par 4 të LPP-së, për faktin se ka pranuar dokumente në gjuhën Bullgare

nga OE i rekomanduar për kontrate, e kjo dispozitë ligjore përcakton qartë se në cilat gjuhë mundën të ofertojnë operatorët ekonomik me një aktivitet të prokurimit citat:

*13.4. Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.*

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesë padi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
Nuhi Paçarizi



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK – KK Rahovec
- 1x1 OE- "Matrix IM" sh.p.k & X shpk
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.